Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica;	06.05.2022	16.05.2022	*122/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.04.2022 OE **"Inovix" Sh.p.k- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr. 122/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë GOE "**Genius Kosova sh.p.k.; Madekos sh.p.k",** lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: "**Ritenderim-Furnizim me material hargjues për laborator për nevojat e QKMF, Ferizaj**", me nr. të prokurimit: **656-22-1881-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **KK –Ferizaj.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 105 000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....14.03.2022.
Hapja e ofertave.....04.04.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....15.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....19.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....22.04.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE **"Inovix" Sh.p.k- Prishtinë**

Dispozitat e shkelura

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 53 – Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ankesë kunder njoftimit mbi vendimin e AK-se te dates:15.04.2022 te publikuar ne e-prokurim brenda afatit ligjor parashtrohet nga Inovix si pale me interes material ne pajtim me Nenin 108/A Paragrafi 3.*2* **"në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brendaafatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.**
Me daten 15.04.2022 permes e-prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin AK-se me te cilin jemi shpallur te papergjegjshem me tekstit si vijon:

Sipas kërkesës për Letër Standarde nga Zyra e Prokurimit me datën 12.04.2022, ne kemi kërkuar që të sillni referencën për Kontratën me titull "Furnizim me kimikale për laborator" me Nr.Prokurimit: KEKO-19-384-121, ndërsa referencën të cilën e keni dërguar si dëshmi, data e lëshmit të referencës nga KEK – [Korporata Energjetike e Kosovës], ka qenë data 14.04.2022 e që në fakt nuk është në përputhje me afatin siç është paraparë në njoftimin për Kontratë.

Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmia e kërkuar
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, furnizime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 150,000.00 €	Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur ne origjinal . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve.

Zyra e prokurimit dhe komisioni vleresues ka vepruar ne kundershtim me Nenin 53 dhe 59 te LPP-se, sepse nuk ka pasur nevoje te kerkohet sqarim shtese qe te dergohet referenca nga KEKU, per arsye se nga lista e kontratave te dorezuara (**pa kontraten e Kekut dhe referencen**) ne oferte me referenca te bashkangjitura e tejkalojne vleren e kerkuar ne dosje te tenderit mbi **150,000.00** Euro.
Nga lista e kontratatve ne 3 vitet e fundit te dorezuar ne oferte me referenca para dates se publikimi te njoftimit për kontrate pa perfshire kontraten e kekut dhe referencen ne fjale arrijne ne vleren prej **196,827.00 Euro** qe tejkalon vleren e kerkuar ne dosje te tenderit prej **150,000.00** Euro.

Andaj, komisioni vleresues dhe zyra e prokurimit ka vepruar ne kundershtim me Nenin 53 te LPP-se duke kerkuar sqarime shtese per nje dokumnet qe nuk e ka ndryshuar KUSHTIN MATERIAL TE TENDERIT edhe ne rastin qe nuk e ka plotesuar kerkesen dhe deshmine kerkuar dokumenti ne fjale.

Njeherit komisioni vleresues dhe zyra e prokurimit oferten e pergjegjshme e ka kualifikuar te papergjegjshme perkunder qe kemi tejkaluar vleren e kerkuar ne DT, andaj kjo bie ndesh me Nenin 59 paragrafi 4 ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".***

Autoriteti kontraktues me kete vleresim ne kundershtim me kerkesat e dosjes se tenderit perveq qe ka ekzaminuar dhe vleresaur oferten e papegjegjshme perkunder qe kemi plotesuar te gjitha kerkesat ne fjale ka bere shkelje te Nenit 6 paragrafi 1 te LPP-***se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.***

Gjithashtu AK-ja me kete vleresim dhe ekazminim ka diskriminuar oferten duke shpall te papergjegjshme qe ne fakt ka plotesuar dhe tejkaluar vleren e kerkuar ne DT, andaj ky eshte nje diskriminim dhe favorizim i tenderuesve me cmim me te larte.

Siq e cekem me larte parimin e ekonomicitetit, AK-ja perveq shkeljeve te cekura me larte ka bere njeherit shkeljen e radhes te kriterit te dhenies se kontrates ***Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet***, sepse oferta e pergjegjshme qe ka plotesaur kerkesat dhe kriteret te DT Inovix shpk ka plotesuar dhe kriterin e dhenies se kontrates sipas Nenin 60 te LPP-se.

Te bashkangjitur keni:

Listen e kontratatve te dorezuar ne oferte dhe referencat perkatese.

Kerkojme nga autoriteti kontraktues qe te merre ne konsiderate ankesa dhe provat e bashkangjitura dhe te bej nje vleresim ne pajtim me Nenin 59 dhe 60 te LPP-se, duke rekomanduar per kontrate Inovix shpk, sepse kemi plotesaur kerkesat e dosjes se tenderit dhe te dhenies.

PROPOZIM

TE APROVOHET- Ankesa si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit te kthehet ne RIVLERESIM, sepse kemi plotesuar kerkesat e dosjes se tenderit dhe kriterin e dhenies Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet.

Inovix sh.p.*k* pret përgjigje nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit/njësia e kërkesës ne afat 3 ditësh ne pajtim me Nenin 6 paragrafi 3 te Rregullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave.

Me respekt

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

2.Çertifikata e TVSH-së,

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

N/A

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, furnizime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 150,000.00 €

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1.Kopje- Certifikata e Biznesit për veprimtari adekuate

2.Kopje- Certifikata e TVSH

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

N/A

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur ne origjinal . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komuna Ferizaj- Zyra e Prokurimit **shpërblen** me kontratë:
Grupin e Operatorëve Ekonomik
GENIUS KOSOVA SH.P.K.; MADEKOS SH.P.K.,

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE **"Inovix" Sh.p.k- Prishtinë**

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se arsyeja e eliminimit tonë nuk qëndron dhe se pretendon se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 dhe 59 të LPP-së, sepse nuk ka pas nevojë të kërkoj sqarime shtesë që të dërgohet referenca nga KEK-u, sepse lista e kontratave të dorëzuara (pa kontratën e KEK-ut dhe referencën) në ofertë me referencat të bashkangjitura e tejkalojnë vlerën e kërkuar në dosje të tenderit mbi 150 000.00 Euro.

Gjithashtu AK-ja me vlerësimin dhe ekzaminim ka diskriminuar ofertën tonë duke na shpall te papërgjegjshme qe ne fakt ne kemi plotësuar dhe tejkaluar vlerën e kërkuar ne DT, andaj ky është një diskriminim dhe favorizim i tenderuesve me çmim më të larte. Po ashtu AK-ja ka bërë shkelje të nenit 6 dhe nenit 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, furnizime, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 150,000.00 €".*

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur ne origjinal . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve*".

Eksperti shqyrtues pasi ka analizuar dokumentacionin e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit thekson se si arsye e eliminimit të OE ankues në letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm është: *Sipas kërkesës për Letër Standarde nga Zyra e Prokurimit me datën 12.04.2022, ne kemi kërkuar që të sillni referencën për Kontratën me titull "Furnizim me kimikale për laborator" me Nr.Prokurimit: KEKO-19-384-121, ndërsa referencën të cilën e keni dërguar si dëshmi, data e lëshimit të referencës nga KEK – [Korporata Energjetike e Kosovës], ka qenë data 14.04.2022 e që në fakt nuk është në përputhje me afatin siç është*

paraparë në njoftimin për Kontratë **”.**

OE ankues në ofertën e tij ka bashkangjitur një listë të kontratave të realizuara në tre vitet e fundit. Mbi bazën e dëshmive të ofruara nga OE ankues, eksperti shqyrtues mendon se OE është eliminuar padrejtësisht nga ana e AK-së për faktin se edhe pa referencën e KEK-ut, OE ankues e arrin vlerën prej 150 000.00 Eurove kontrata të ngjashme furnizime. Nga kërkesa e AK-së kuptohet që AK-ja ka kërkuar kontrata të ngjashme furnizim dhe jo kontrata identike apo të njëjta dhe për deri sa vetë AK-ja e ka theksuar kontrata të ngjashme furnizime ather do duhej që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, gjithashtu AK-ja do duhej që ta ketë parasysh kriterin e dhënies së kontratës të përcaktuar në dosje të tenderi. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar**.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Inovix” Sh.p.k- Prishtinë” të aprovohet si e bazuara, dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK - Ferizaj

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues -OE “Inovix” Sh.p.k- Prishtinë